

VENDIM
Nr.1051, datë 22.12.2010

PËR KALIMIN E PASURISË ME NR.5/409, NË ZONËN KADASTRALE NR.8513, TË RRETHIT DURRËS, ME SIPËRFAQE 1128.72 M², NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT (ENTIT KOMBËTAR TË BANESAVE) DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.536, DATË 1.5.2008 “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË DURRËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 8 dhe të neneve 10, 12, 13 e 15/c të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e pasurisë me numër 5/409, të ndodhur në zonën kadastrale nr.8513, të rrethit Durrës, me sipërfaqe të përgjithshme 1128.72 (një mijë e njëqind e njëzet e tetë pikë shtatëdhjetë e dy) m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (Entit Kombëtar të Banesave), sipas listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë e Durrësit, për ndërtimin dhe shitjen e banesave, në zbatim të politikave sociale të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

2. Pasuria me nr.5/409, me sipërfaqe 1128.72 m² (një mijë e njëqind e njëzet e tetë pikë shtatëdhjetë e dy), në zonën kadastrale nr.8513, në rrethin e Durrësit, hiqet nga lista e inventarit me nr.1207, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.536, datë 1.5.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit”.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme, të Republikës së Shqipërisë, Ministri i Punëve Publike dhe Transportit dhe Enti Kombëtar i Banesave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

1.FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Për inventarizimin e pronave të veçanta)

Institucion i pushtetit qendror: Ministria e Punëve Publike e Transportit
Enti Kombëtar i Banesave
Fusha e përdorimit të pronës: truall

Nr.rendor	A			B			C			
	Zona Kadastrale&indeksi i hartës	Nr.i pasurisë	Lloji i pronës	Emri i pronës, adresa	Sip totale e pronës (m ²)	Nga sip totale: sa ndërtesë m ²	Funksioni për të cilin përdoret prona	Institucioni/enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/enti përdorues Statusi juridik i përdorimit	Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8513 DR-H, I-6,7	5/409	Tokë truall	Durrës	1128.72	–	Truall i lirë	Shtet	Shtet	S'ka

3. FORMULAR PËR INVENTARIZIMIN E PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
(Të tipit të pronave që inventarizohen si klasa të veçanta)

1201	8513 H,I-4,5	1/394 1/399 1/407	Troje brenda territorit të bashkisë Durrës	Truall	Në territorin e bashkisë Durrës	2920	Infrastrukturë vendore	Bashkia Durrës	Bashkia Durrës	1/409; 1/411; 1/423; 1/455; 1/494; 1/518; 1/542; 1/549; 1/579; 1/581
1202	“	1/216 1/223 1/224		Truall dhe shesh midis pallateve	Lagje nr.18 Durrës	4267	“	“	“	1/249; 1/251; 1/256; 1/283; 1/355; 1/356; 1/359; 1/364; 1/366
1203	8513 F,G-6,7 H,I-6,7	2/177 2/180 2/191		Truall	Lagja nr.17 Durrës	17628.7	“	“	“	2/197; 2/204; 2/243; 2/452; 2/378; 2/386; 2/394; 2/604; 2/454; 2/477
1204	8513 F,G-6,7	2/90 2/92 2/98		“	“	17904	“	“	“	2/105; 2/110; 2/116; 2/121; 2/124; 2/129; 2/139; 1/153; 2/155; 2/176
1205	“	2/4 2/12 2/17		Truall dhe shesh midis pallateve	“	13224	“	“	“	2/19; 2/27; 2/34; 2/41; 2/43; 2/47; 2/62; 2/69; 2/75; 2/78
1206	8513 H,I-6,7	5/255 5/257 5/260		Truall	“	8514	“	“	“	5/262; 5/265; 5/268; 5/273; 5/277; 5/278; 5/283; 5/288; 5/300; 5/302; 5/306
1207	“	5/320 5/321 5/336		“	“	15833	“	“	“	5/344; 5/352; 5/358; 5/361; 5/380; 5/391; 5/409; 5/411; 5/146; 5/435; 5/446; 5/448; 5/161
1208	“	6/28 6/32 6/45		“	Në territorin e Bashkisë Durrës	3777	“	“	“	6/75; 6/83; 6/92; 6/98; 6/100; 6/101; 6/104; 6/111; 6/112; 6/149; 6/152